

RREGULLORE (QRK) Nr. 12/2015 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES Nr. 42/2013 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË SEKRETARIATIN DHE QENDRËN E SITUATAVE TË KËSHILLIT TË SIGURISË TË KOSOVËS

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe duke u bazuar në nenin 16.1 të Ligjit mbi Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, në pajtim me nenin 33 të ligjit nr. 03L-189 "Për administratën shtetërore", si dhe në pajtim me nenin 19 (6.2) të Rregullores Nr.09/2011 së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe nenit 23 paragrafi 10 të Rregullores nr.09/2012 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Shtetërore,

Miraton:

RREGULLORE (QRK) Nr. 12/2015 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES Nr. 42/2013 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË SEKRETARIATIN DHE QENDRËN E SITUATAVE TË KËSHILLIT TË SIGURISË TË KOSOVËS

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregullore është ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores nr. 42/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariatit dhe Qendrën e Situatave të Këshillit të Sigurisë të Kosovës.

Neni 2

Neni 6, nënparagrafi 1.4, fshihet "Auditori i brendshëm", dhe zëvendësohet me "Zyrtar për Arkiv/Protokoll".

Neni 3

Neni 8 (auditor i brendshëm) fshihet komplet.

Neni 4

Nenit 12 paragrafi 1, pas nënparagrafit 1.18 i shtohet nënparagrafi 1.19 si në vijim:

1.19. Te regjistroj dhe administroj pasurinë e institucionit duke ofruar edhe mbështetje teknike dhe operative për zbatimin e praktikave më të mira menaxhuese të logjistikës, sistemeve dhe procedurave.

Neni 5

Paragrafi 2 i Nenit 12 riformulohet si ne vijim:

Neni 6

2. DA-i udhëhiqet nga drejtori i administratës, i cili i raporton Sekretarit të KSK-së. Numri i të punësuarve në Drejtoratin e Administratës është tetë (8).

Neni 7

Neni 12, Paragrafi 2, nënparagrafi 2.7, “Zyrtar i lartë i TI-së/Arkivit”, zëvendësohet me “Udhëheqës i njesisë për Teknologji Informative”

Neni 8

Neni 12, Paragrafin 2, pas nënparagrafit 2.7 i shtohet nënparagrafi 2.8 “Zyrtar i Logjistikës/Pranimi”.

Neni 9

Neni 13 Paragrafi 6 fshihet komplet dhe zëvendësohet me “Numri i të punësuarve në Qendrën e Situatave është 9”.

Neni 10

Neni 14 fshihet komplet.

Neni 11

Neni 15 fshihet komplet.

Neni 12

Neni 16 fshihet komplet.

Neni 13

Organogrami i Sekretariatit dhe Qendrës së Situatave të Këshillit të Sigurisë të Kosovës fshihet dhe zëvendësohet me organogramin e ri të Sekretariatit dhe Qendrës së Situatave të Këshillit të Sigurisë të Kosovës.

RREGULLORE (QRK) Nr. 12/2015 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES Nr. 42/2013 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË SEKRETARIATIN DHE QENDRËN E SITUATAVE TË KËSHILLIT TË SIGURISË TË KOSOVËS

Neni 14

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga ana e Kryeministrit dhe publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Isa Mustafa

Kryeministër i Republikës së Kosovës

14 Gusht 2015

Rregullore QRK - nr. 12/2015 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 42/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Sekretariatit dhe Qendrën e Situatave të Këshillit të Sigurisë të Kosovës, është miratuar në mbledhjen e 43 të Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendimin numër 04/43 me datë 05.08.2015.

STRUKTURA ORGANIZATIVE

